<p>Java e 11 Identifikon më shumë burime të zërit.</p> <p>Hulumtimi shkencor Ide dhe fakte: Përpiqet të përgjigjet në pyetjet duke mbledhur fakte nëpërmjet të vëzhgimit.</p> <p>Planifikim i punës hulumtuese: Vendos se çfarë do të bëjë për tu përgjigjur në pyetjet hulumtuese.</p> <p>Marrja dhe paraqitja e dëshmive: Hulumton, vëzhgon dhe mbledh fakte (matje dhe vëzhgime) që të përgjigjet në pyetjet.</p> <p>Rishikimi i fakteve dhe qasja: Krijon ide dhe diskuton për ato me qëllim që ti shpërndaj, sqaroj dhe zhvilloj.</p>	<p>Njësia 21: Analizoni se çfarë mund të bëni me zërin</p> <p>Dëgjoni muzikën dhe njihi instrumentet individuale të cilat japin zë. Imitoni si bëjnë zë instrumentet e caktuara. Formoni orkestër të qetë. Lozni së bashku dhe mund ta këndonni muzikën të cilët e dëgjoni.</p> <p>Në çifte bisedoni mbi atë se prej nga vjen tingulli.</p> <p>Vëzhgoni efektet të shkaktuara nga zëri duke vendosur disa koka orizi në lëkurën e tupanit. <i>Çfarë do të ndodh kur do ti biesh tupanit?</i></p> <p>Dëgjoni ndonjë muzikë nëpër mjet të zmadhuesve të sistemit muzikor. Shtrini zmadhuesin në sipërfaqe të rrafshët dhe vendosni ndonjë letër mbas zmadhuesit prej nga emitohet zëri. Hidhni kripë mbi letër . Rrotulloni pullën për rregullimin e intensitetit të zërit në më të qetë dhe më të fortë dhe vëreni se çfarë do të ndodhë. Përsëritni veprimin duke përdorur sheqer në vend të kripës.</p> <p>Demonstroni zë duke shfrytëzuar pirunin e zëshëm. Trokitni në tavolinë, dhe më pas vendosni në sipërfaqen e enës së mbushur me ujë- vëzhgoni efektet.</p> <p><i>Si shpërndahet zëri? Vallë shpërndahet shpejtë ose ngadalë?</i></p>	<p>Sistem muzikor dhe CD ose muzikë në internet</p> <p>Oriz. tupan</p> <p>Zmadhues prej sistemit muzikor, letër, kryp, sheqer.</p> <p>Piruni për zë, gotë e mbushur me ujë.</p>	<p>Shprehjet kryesore tingull zë i butë i qetë dëgjim vesh dëgjon instrumente muzikore me goditje me fryrje me tela</p> <p>Hulumtimi shkencor: - flet - parashton pyetje - dëgjon - qëllon (parasheh) - sheh - zbulon - shkruan / vizaton - emëron - tregon - sqaron/bisedon - krahason. Disa nxënës mendojnë se prodhuesi është në fakt brenda në zmadhuesin!</p> <p>Të jeni i sigurtë nxënësit din se si ta ndryshojnë intensitetin e zërit te zmadhuesit. Këshilloni që të mos e bëjnë provë kripën sheqerin ose orizin.</p> <p>Sqaroni se ne nuk mund ta shohim zërin, por mund ta vërejmë se çfarë efektësh kemi nga zëri.</p>


Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset	Vërejtjet
Fizikë (zëri)			
<p>Java 11</p> <p>Njihuni se me largimin e zërit nga burimi, ai bëhet më i dobët dhe më i pa qartë.</p> <p>Hulumtimi shkencor Ide dhe fakte: Përpiqet të përgjigjet në pyetjet duke mbledhur fakte nëpërmjet të vëzhgimit.</p> <p>Planifikim i punës hulumtuese: parashikon.</p> <p>Rishikimi i fakteve dhe qasja: Krahason, I krahason parashikimet me rezultatet e fituara.</p>	<p>Njësia 22: Zëri dhe largësia Luani lojën interaktive e cila do tju ndihmoj të bëhet dallimi në mes zërave që janë afër nesh dhe atyre që janë larg nesh. Ndiqni dhe klikoni linkun e preferuar nga mosha 5 deri 7 vjetë (ages 5-7), Energjin, zëri dhe dëgjimi (Energy, Sound and hearing), Tregoni rregullat e zërave Play your sounds right. Zgjidhni aktivitetet të jetë I nivelit të latrë (hard level).</p> <p>Në çifte: diskutoni për zërat e përditshme psh. Vetura e ndihmës së shpejtë (ambulanca, zjarëfiksi ...) trafiku etj. Diskutoni dhe shkëmbeni ide (e gjithë klasa së bashku).</p> <p>Dilni jashtë dhe formoni rreth. Merrni instrumente muzikore ose diçka të ngjashme që shkaktojnë zë që mund ti përdorim si sinjale të zërit. Tregoni nxënësve të kthehen nga ana e kundërt e rrethit. Qëndroni në mes të rrethit dhe bëni ndonjë zë. Thoni nxënësve që të largohen nga ju dhe në momentin kur nuk do të mund të dëgjojnë zërin të ndalen dhe të ulen. Le të rin ulur për deri sa do të ulet edhe nxënësi i fundi dhe më pas shihni pozitat e tyre se në çfarë largësi janë. <i>Çfarë vërehet kur je më larg nga burimi i zërit?</i></p>	<p>www.scibermonkey.org</p> <p>Burimet e zërit</p>	<p>Shprehjet kryesore tingull zë i butë i qetë dëgjim vesh dëgjon trekëndësh qeparë (çinele)</p> <p>Hulumtimi shkencor: - flet - parashtron pyetje - dëgjon - qëllon (parasheh) - zbulon - shkruan / vizaton - emëron - tregon - sqaron/bisedon - krahason.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset	Vërejtjet
Fizikë (zëri)			
<p>Java e 12</p> <p>Njihuni se me largimin e zërit nga burimi, ai bëhet më i dobët dhe më i pa qartë.</p> <p>Hulumtimi shkencor Ide dhe fakte: Përpiqet të përgjigjet në pyetjet duke mbledhur fakte nëpërmjet të vëzhgimit.</p> <p>Planifikim i punës hulumtuese: parashikon.</p> <p>Rishikimi i fakteve dhe qasja: Krahason, I krahason parashikimet me rezultatet e fituara.</p>	<p>Ora e 23: A mundet burimet e zërve të ndryshëm të dëgjohen në distance të ndryshme?</p> <p>Përsëritni aktivitetin paraprak (të përshkruar më lartë) duke shfrytëzuar burime të ndryshme të zërit: <i>A ka ndonjë ndryshim ? Parashikoni se cili prej tyre do të dëgjohej më larg nga burimi i zërit . Cili burim i zërit mund të vërehet në distancë më të madhe? Pse?</i></p> <p>Diskutoni dhe krahasoni se çfarë Ju tregojnë rezultatet për burimet e zërit të ndryshme. Silleni vendimin se cili është burimi më i mirë i zërit dhe pse.</p>	<p>Trekëndësh dhe qepare (çinele) / ose objekte që prodhojnë zë</p> <p>Lapsa dhe letra ose fletore pune.</p>	<p>Shprehjet kryesore tingull zë i butë i qetë dëgjim vesh dëgjon trekëndësh qepare (çinele)</p> <p>Hulumtimi shkencor: - flet - parashtron pyetje - dëgjon - qëllon (parasheh) - zbulon - shkruan / vizaton - emëron - tregon - sqaron/bisedon - krahason.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset	Komentet
Fizikë (zëri)			
<p>Java 12 dhe 13</p> <p>Njihuni se me largimin e zërit nga burimi, ai bëhet më i dobët dhe më i pa qartë.</p> <p>Hulumtimi shkencor Ide dhe fakte: Përpiqet të përgjigjet në pyetjet duke mbledhur fakte nëpërmjet të vëzhgimit.</p> <p>Planifikim i punës hulumtuese: parashikon.</p> <p>Rishikimi I fakteve dhe qasja: krahason I krahason parashikimet duke i fituar rezultatet.</p>	<p>Njësia 24: planifikim i hulumtimit për zërin</p> <p>Njësia 25: Realizim i hulumtimit për zërin</p> <p>Në grupe: Provoni burime të ndryshme të zërave. Psh. Trekëndësha, qepare (çinele) (instrumente të vogla muzikore).</p> <p>Tregoni nxënësve se si burimi i zërit do të fitoj instrumente muzikore të vogla. Ato duhet të hulumtojnë se në cilën largësi zërat mund të dëgjohen (përsëritni aktivitetin paraprak si është sqaruar më lartë, por grupet të përdorin burime të ndryshme të zërit).</p> <p>Lejoni grupet të planifikojnë (bisedojnë) parashikojnë dhe ta realizojnë aktivitetin. <i>Cili burim i zërit ishte ma i mirë?. Prej nga e dini?</i> Krahasoni burime të ndryshme të zërit duke i shfrytëzuar rezultatet e fituara nga grupet e ndryshme të nxënësve. Luteni nxënësit të shënojnë dhe të tregojnë me të vërtet se çfarë ka ndodhur.</p>	<p>Zgjedhje e instrumenteve muzikore ose mjete të cilat shfrytëzohen për të shkaktuar zë.</p> <p>Letër dhe laps ose fletore pune</p>	<p>Shprehjet kryesore tingull zë i butë i qetë dëgjim vesh dëgjon trekëndësh qepare (çinele)</p> <p>Hulumtimi shkencor: - flet - parashtron pyetje - dëgjon - qëllon (parasheh) - zbulon - shkruan / vizaton - emëron - tregon - sqaron/bisedon - krahason.</p> <p>Paraprakisht rregulloni grupet të jenë të ndara jashtë shkollës, ashtu që nuk do të jenë të penguar nga burimet e ndryshme që i përdorin grupet e tjera nga me nxënës.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset	Komentet
Fizikë (zëri)			
<p>Java e 13</p> <p>Perceptimi se ne dëgjojmë kur zëri hyn në veshin tonë.</p> <p>Hulumtimi shkencor Planifikimi punës hulumtuese: Parashikon. Rishikimi i fakteve dhe qasja: I krahason parashikimet me rezultatet e fituara.</p>	<p>Ora e 26: Si dëgjojmë?</p> <p>Në çifte bisedoni për atë se si reagojmë me gjymtyrët tona kur dëgjojmë muzikë të lartë. Mendoni për të shkuar në vende ku njerëzit janë të detyruar të punojnë në rrethe me zhurmë, psh. Vende ku ndërtohet, industri muzikore etj.</p> <p>Në grupe hulumtoni për atë se si dëgjojmë. Diskutoni dhe propozoni disa mundësi psh. Duke mbajtur kapa të ndryshme, duke bërë mbrojtëse për veshët nga material të ndryshme ose duke dëgjuar zëra dhe vendosur materiale të ndryshme në mes burimit të zërit dhe veshëve tona.</p> <p>Pyetni se çfarë ju nevojitet, çfarë duhet të bëni, Parashikoni se çfarë do të ndodhë-më pas realizoni testin.</p> <p>Orientoni nxënësit në planifikimet e tyre: Çfarë përgatitjesh ju nevojitet? Çfarë do të bëni për ti analizuar materialet që e bllokojnë zërin? Parashikoni se çfarë do të ndodhë, Realizoni vlerësimin Sqaroni ose tregoni se çfarë ndodhi.</p>	 <p>Kapela të ndryshme, zgjedhje e materialeve të ndryshme, psh. Material si ballonë që plasim kur i shtypim (shih fotografimin e mësipërme) pambuk, letër etj Burime të zërit.</p>	<p>Sqaroni se ne e dëgjojmë zërin kur do të hyjë në vesh. Nëse përpiqemi ta fshehim, zërin nuk mund edhe aq mirë ta dëgjojmë.</p> <p>Shprehjet kryesore tingull zë i butë i qetë dëgjim vesh dëgjon</p> <p>Hulumtimi shkencor: - flet - parashtron pyetje - dëgjon - sheh - tregon - sqaron/flet - krahason</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset	Komentet
Fizikë (zëri)			
<p>Java e 14</p> <p>Perceptimi se ne dëgjojmë kur zëri hyn në veshin tonë.</p> <p>Hulumtimi shkencor Planifikimi punës hulumtuese: Parashikon Rishikimi I fakteve dhe qasja: I krahason parashikimet me rezultatet e fituara.</p>	<p><u>Ora 27: Zërat që dëgjojen.</u></p> <p>Luani lojën “ Telefoni i prishur”: Uluni në rreth. Nxënësi/nxënësja i parë të jetë si udhëheqës i parë, i pëshpëritet në vesh një fjali e shkurtër ose porosi shokut që e ka më pranë vetes. Porosia përcillet në rreth në mes nxënësve për deri sa do të kthehet në fillim. porosia para dhe pas pëshpëritjes krahasohet njëra me tjetrin. Bisedoni se si dhe pse porosia është ndryshuar gjatë kohës së përcjelljes së saj gjatë përcjelljes në rreth. Luajeni lojën disa herë deri sa të gjithë nxënësit të kuptojnë se çfarë ndodh.</p> <p>Tregoni nxënësve ti mbulojnë veshët. Mundoheni të qëlloni se çfarë ju thotë arsimtari. Arsimtari thotë fjale nga ndonjë këngë e njohur ose poezi. Përsëritni lojën disa herë - lejojuni nxënësve të jenë në rolin e arsimtarit (udhëheqës) ku do të thotë fjali nga ndonjë këngë e njohur ose poezi dhe pjesëmarrësit tjerë ta qëllojnë.</p> <p>Jepuni të gjithë nxënësve nga një gotë plastike të prerë poshtë dhe le ta vendosin te veshi. Luteni të kthehen në drejtim të burimit dhe të jenë sa më larg nga burimi dhe krahasoni se çfarë ndodhë. Bisedoni për krahasimin kur do të kthehet në drejtim të burimit por në largësi sa më të madhe nga burimi.</p>	<p>Gotë letre me fund të prerë</p>	<p>Shprehjet kryesore tingull zë i butë i qetë dëgjim vesh dëgjon</p> <p>Hulumtimi shkencor: - flet - parashtron pyetje - dëgjon - sheh - tregon - sqaron/flet - krahason</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset	Komentet
Fizikë (zëri)			
<p>Java e 14</p> <p>Perceptimi se ne dëgjojmë kur zëri hyn në veshin tonë.</p> <p>Hulumtimi shkencor Planifikimi punës hulumtuese: Parashikon</p> <p>Rishikimi I fakteve dhe qasja: I krahason parashikimet me rezultatet e fituara.</p>	<p>Ora e 28: Bërja e telefonit nga telat dhe konservat kanacet)</p> <p>Paraprakisht keni parasysh që nxënësve tju siguronit mjete të domosdoshme që nxënësit të ndërtojnë telefonin e prishur nga conserva dhe telit. Përdorni dy conserva të shpuara me baza të barabarta. Bëni një birë në fundin dhe fusni një cop teli nëpër të dyja bazat e konservës dhe lidhni me nyje.</p> <p>Demonstroni se si ta bëjnë ose shfrytëzojnë - zgjidhni nxënës vullnetar që tju ndihmojnë gjatë demonstrimit,</p> <p>Në çifte: Njëri nxënës e vendos konservën në veshë, përderisa nxënësi tjetër flet në konservën tjetër dhe anasjelltas. <i>Çfarë do të ndodh? Vallë a do të mund ta dëgjojë shokun nëse ato nuk shihen mes veti njëri me tjetrin? Proveni dhe shihni.</i></p>	<p>Telefon prej konservave dhe telit(paraprakisht të përgatitur)</p>  <p>Konserva të zbrazura nga ushqimi ose pijet, një material i mprehtë me të cilin do të duhet ta bëni birën në konservë . teli, gërshtë.</p> <p>Shëndet /siguri: Mos lejoni që nxënësit të bëjnë birën në konservë (kanaçe) dhe jepuni këshilla që të mos i fusin duart në konservë pasi që mund edhe të prehen në skajet e mprehta të konservës (kënaçes)</p>	<p>Shprehjet kryesore tingull zë i butë i qetë dëgjim vesh dëgjon telefon</p> <p>Hulumtimi shkencor: - flet - parashtron pyetje - dëgjon - sheh - tregon - sqaron/flet - krahason</p> <p>Ato mund ta dëgjojnë personin i cili flet nga largësia e caktuar-veçanërisht nëse teli është i përforcuar mirë dhe i lagët</p>

Tema 2C: 1.6. Kultivimi i bimëve

Kjo temë i njofton nxënësit me bimët si qenie të gjalla.

Ata mësojnë se bimët rriten ndërsa përmes rritjes ndryshohen.

Nxënësit vetëdijesohen për ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet bimëve.

Ekzistojnë mundësi për njohuritë e tyre për rritjen e bimëve me të kuptuarit e tyre të shkencës.

Njihen dhe ju sqarohen ide se si të veprojnë ndaj bimëve që rriten.

Hulumtimi shkencor	
Qëllimet e mësimit	Vokabular i rekomanduar për këtë temë
<p>Idetë dhe dëshmitë: Nxënësi/nxënësja: -përpiqet të përgjigjet në pyetjet me grumbullimin e dëshmive përmes vëzhgimit.</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese: - parashtron pyetje dhe merr pjesë në diskutimin që të arrihet në përgjigje; - parashikon; - vendos se çka të bëjë që të përgjigjet në pyetjen shkencore.</p> <p>Marrja dhe paraqitja e dëshmive: - hulumton, vëzhgon dhe mbledh dëshmi (matje dhe vëzhgime) që të përgjigjet në pyetjet; - propozon ide dhe që ti vijon udhëzimet; - evidenton faza të punës.</p> <p>Qasja dhe shqyrtimi i dëshmive: - bën krahasime; - krahason parashikime me rezultatet e fituara; - krijon ide dhe diskuton për ata me qëllim që ti ndajë, sqarojë dhe zhvillojë.</p>	<p>Bimët Gjethi Rrënjët Lulja Fara Rritja Drita Uji</p> <p>Hulumtimi shkencor</p> <p>Pyet Përgjigjet Tregon/flet Qëllon/parashikon Shkruan/vizaton Krahason Ndan Fer test (kushte të barabarta)</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p>Java e 15 E din se bimët janë qenie të gjalla.</p> <p>Hulumtimi shkencor</p> <p>Idetë dhe dëshmitë Përpiqet të përgjigjet në pyetjet me mbledhjen e dëshmimeve përmes vëzhgimit.</p> <p>Shqyrtimi i dëshmimeve dhe qasja Bën krahasime.</p>	<p>Ora e 29: Bimët janë qenie të gjalla Nxënësit në çift bisedojnë për atë: Si mund të përcaktojmë se ndonjë qenie është e gjallë? Krahasoni ide dhe diskutoni ndërmjet veti.</p> <p>Bëni shëtitje rreth shkollës oborrit – vizatoni apo fotografoni secilën bimë të gjetur. Emëroni secilën bimë të gjetur. Shfrytëzoni fotografitë apo vizatimet që të krahasohen gjethet, stomet, lulet dhe ngjyra. Pyetni nxënësit se vallë ndonjëherë kanë mbjellë disa fara dhe se vallë janë kujdesur për ndonjë bimë. Bisedoni për atë se çka i nevojitet një bime (ujë, dritë dhe ngrohtësi).</p> <p>Pyetni nxënësit se vallë ndonjëherë kanë mbjellur ndonjë lloj farash dhe se vallë jeni kujdesur për ndonjë bimë. Bisedoni për atë se çka i nevojitet një bime (ujë, dritë dhe ngrohtësi).</p> <p>Bëni vizatim me bimë të shëndoshë.</p> <p>Vizatoni tabelë me ngjarje të shkurtër që të tregohet se si duhet të kujdesemi për bimët.</p>	<p>Lapsa dhe letër, kamerë digjitale për inçizim.</p> <p>Shëndet - siguri Rikujtoni nxënësit që mos ti këpusin lulet/bimët dhe ti lajnë duart nëse kanë prekur lule/bimë.</p>	<p>Të sqarohet se bima e shëndoshë zakonisht ka sistem të mirë të rrënjës. Gjethe të gjelbërta, stome dhe ndonjëherë lule dhe fryte.</p> <p>Të rikujtohen nxënësit që mos të mbledhin lule.</p> <p>Vokabulari kryesor/nocionet: bimë gjethi trungu rrënjët lulja fara rritet fushë ujit dritë.</p> <p>Hulumtimi shkencor: pyet përgjigjet tregon/bisedon për funksion krahason.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p>Java e 15 Emëron pjesë kryesore të bimëve, vështron bimë të vërteta dhe modele.</p> <p>Hulumtimi shkencor</p> <p>Idetë dhe dëshmitë Përpiqet të përgjigjet në pyetjet përmes vështrimit.</p> <p>Pranon dhe paraqet dëshmi Propozon ide dhe përcjell instruksione.</p> <p>Shqyrton dëshmi dhe qasje Bën krahasime; Modelon dhe bisedon për idetë të ndahen, sqarojnë dhe të zhvillohen.</p>	<p>Ora e 30: Emërimi i pjesëve të bimëve</p> <p>Këndoni këngë për bimët (shembuj në ueb - faqe).</p> <p>Shikoni bimët natyrore dhe artificiale dhe emëroni pjesët – rrënja, gjethi, trungu, lulet.</p> <p>Vështroni skemat artistike të farave të pemëve në pemët e prera në gjysmë – shikoni hiperlinkun për alfabetin e pemëve të pemëve të ndryshme në tërë botën.</p> <p>Nxënësit vihen në pozita të ndryshme me qëllim që me trupat e tyre të bëjnë kolazh të bimëve – disa nxënës shtrihen në dysheme dhe paraqesin rrënjë, tjerët qëndrojnë drejtë që ta bëjnë.</p>	<p>www.mrsjonesroom.com/themes/plants.html</p> <p>www.thefruitpages.com/alphabet.shtml</p> <p>Hapësirë e madhe</p>	<p>Vokabulari kryesor/nocione:</p> <p>bimë gjethi gjethet trungu rrënja lulja fara rritet drita uji.</p> <p>Hulumtimet shkencore:</p> <p>pyet përgjigjet tregon/bisedon për shkruan/vizatton krahason.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p>Java e 16 Emëron pjesë kryesore të bimës, vështron bimët e vërteta dhe modele.</p> <p>Hulumtimi shkencor</p> <p>Idetë dhe dëshmitë Përpiqet të përgjigjet në pyetjen përmes vështrimit.</p> <p>Merr dhe paraqet dëshmi Propozon ide dhe përcjell instruksione.</p> <p>Shqyrton dëshmi dhe qasjet Bën krahasime; Modelon dhe bisedon për idetë që të ndahen, sqarohen dhe të zhvillohen.</p>	<p><u>Ora e 31: Pjesët e bimëve</u></p> <p>Nxënësit përpunojnë kolazh prej ilustrimeve me bimë dhe i caktojnë pjesët e bimëve.</p> <p>Në çifte: Vështroni fotografi nga bimët e ndryshme dhe lulet dhe krahasoni ato. Krahasoni lulet artificiale dhe natyrore.</p> <p>Përgatitni fletë pune me dy bimë të panjohura për nxënësit. Lutni nxënësit që ti caktojnë pjesët të cilat janë të njëjta apo të vendosin X nëse janë të ndryshme. Madje kanë për detyrë të vizatojnë se si duket gjethi për secilën bimë në veçanti.</p>	<p>Letër, gërshërë, ngjitës, mëndafsh, pupla, pe, tytë për të pirë ujë, kallëp për ëmbëlsira etj.</p> <p>Laps dhe letër apo fletore</p> <p>Fleta pune</p>	<p>Vokabulari kryesor/nocione:</p> <p>bimë gjethi gjethet trungu rrënja lulja fara rritet drita uji.</p> <p>Hulumtimet shkencore:</p> <p>pyet përgjigjet tregon/bisedon për shkruan/vizatton krahason.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p>Java e 16 Emëron pjesë kryesore të bimës, vështron bimët e vërteta dhe modele.</p> <p>Hulumtimi shkencor</p> <p>Idetë dhe dëshmitë Përpiqet të përgjigjet në pyetjen përmes vështrimit.</p> <p>Merr dhe paraqet dëshmi Propozon ide dhe përcjell instruksione.</p> <p>Shqyrton dëshmi dhe qasjet Bën krahasime; Modelon dhe bisedon për idetë që të ndahen, sqarohen dhe të zhvillohen.</p>	<p><u>Ora 32: Eksperiment me gjeth</u></p> <p>Kërkoni gjethë rreth shkollës ti kushtohet vëmendje formës, madhësisë, ngjyrës, ngjashmërive dhe dallimeve. Emëroni secilin gjeth që e gjeni. Me ndihmën e thjerrzës vështroni prej së afërmi gjethin që është i gjetur. Përshkruani dhe paraqitni pjesën e gjethit (pjesë të theksuara nga pjesa e jashtme e gjethit). Bëni vula prej gjethëve me vendosjen e gjethit nën letër dhe me gërvishtjen me shkumës me ngjyrë dylli apo me laps.</p> <p>Kërkoni disa eksperimente me gjethë: Vendosni ujë në tepsi. Vendosni gjethet në tepsi të kthyer me anët lartë. Vendosni tepsinë në dritë. Vështroni me përdorimin e thjerrzës. Vizatoni fotografi nga ajo që e shikoni (paraqiten filluska);</p>	<p>Gjethë, libra referente, qasje në internet, thjerrëza, letër, lapsa, shkumësa dylli.</p> <p>Gjethë, ujë, tepsi me ujë, thjerrëz, lapsa apo fletore pune.</p> <p><u>Shëndeti – siguria.</u> Rikujtoni nxënësit që mos ti hanë gjethet apo mos ti vendosin në gojë. Nxënësit duhet ti lajnë duart pas prekjes së gjethëve.</p>	<p>Vokabular kryesor/nocione:</p> <p>bimë gjethi gjethet trungu rrënja lulja fara rritet drita uji.</p> <p>Hulumtimet shkencore:</p> <p>pyet përgjigjet tregon/bisedon për shkruan/vizaton krahason.</p>
<p><u>Java e 17 deri 20</u></p>	<p><u>Ora 33 - 40</u></p> <p>Aktivitetet e përshkruara në këto njësi mësimore e përfshijnë mbjelljen e bimëve. Nuk pritet prej mësimdhënësve që ti përfundojnë të gjithë aktivitetet e propozuara – por vetëm ata për të cilët lejon koha dhe resurset që të jenë të përfunduara. Nëse bimët e ekspozuara dhe materialet farë nuk janë të inkuadruara, mund të jenë të shkëmbyera me materiale që janë të përfshira në nivel lokal. Secili aktivitet është i shënuar në kuadër të një ore që të sigurojë pasqyrë të aktivitetit si tërësi.</p> <p>Aktivitetet përfshijnë vëzhgim të procesit të rritjes që është fryt i një njësie mësimore. Mësimdhënësi duhet të vendosë se si ajo do të duhet të jetë e organizuar varësisht nga numri i aktiviteteve i cili planifikon ti shfrytëzon. Mësimdhënësit duhet ta planifikojnë aktivitetin e tyre paraprakisht, si dhe realizimin e të njëjtave (vëzhgimi, matja etj) gjatë kohës së orës tjetër apo jashtë nga kornizat e orës. Ata duhet të kenë edhe plan për situata të paparashikuara në rast bima të ngordh apo farat të mos dalin.</p>		

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p>Java e 17 Emëron pjesë kryesore të bimës, shikon bimët e vërteta dhe modelet.</p> <p>Hulumtimi shkencor</p> <p>Idetë dhe dëshmitë Përpiqet të përgjigjet në pyetjen përmes vëzhgimit.</p> <p>Merr dhe paraqet dëshmi Propozon ide dhe përcjell instruksione.</p> <p>Shqyrton dëshmi dhe qasje Bën krahasime; Modelon dhe bisedon për idetë të ndahen, sqarohen dhe të zhvillohen.</p>	<p>Ora 33: <u>Vallë pse shërbejnë rrënjët?</u></p> <p>Lutni nxënësit të vendosin shkop (rrënjë) prej selino në ujë me ngjyrë bimore para se të fillojë ora, është e preferuar që disa orë para fillimit të orëve (apo një ditë paraprak, nëse nevojitet). Në fillim të orës, mësimdhënësi e shkurton rrënjën. Vizatoni se çka shikoni.</p> <p><i>Vendosni lule të gjelbër në kavanoz pa ujë. Leni disa orë. Shtoni ujë dhe vështroni dallimet e dukshme.</i></p> <p><i>Çka na paraqesin këto aktivitete për punën e rrënjëve?</i></p> <p>Kuptoni për bimët e ndryshme nga pjesët e ndryshme të botës, për shembull. bimët në shkretëtirë, bimët që rriten në Arktik.</p>	<p>Selino, kavanoz prej qelqi, ngjyra bimore apo ngjyrë yndyrore, letër dhe laps apo fletore pune</p> <p>Materiali referues – Internet apo libra</p>	<p>Eksperimenti do të jetë më i suksesshëm nëse mësimdhënësit së pari e presin selinon nën ujë e penguar përmes bazës së tyre dhe e lënë në ujë përderisa nuk u jepet nxënësve të cilët duhet ta lënë në ujin e ngjyrosur.</p> <p>Kjo e pengon hyrjen e ajrit në rrënjë dhe e parandalon thithjen e ujit me ngjyrë.</p> <p>Vokabular kryesor/nocione:</p> <p>bimë gjethi gjethet trungu rrënja lulja fara rritet drita uji.</p> <p>Hulumtimet shkencore:</p> <p>pyet përgjigjet tregon/bisedon për shkruan/vizaton krahason.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p>Java e 17</p> <p>Hulumton se si farat zhvillohen në bimët që lulëzojnë.</p> <p>Hulumtimi shkencor Planifikimi i punës hulumtuese</p> <p>Bën parashikime</p> <p>Merr dhe paraqet dëshmi Propozon ide dhe përcjell instruksione.</p> <p>Janë propozuar shumë aktivitete me kultivimin (mbjelljen) – të jeni të përzgjedhur; bëni ata për të cilët keni kohë.</p>	<p>Ora e 34: Kultivimi i farave</p> <p>Nxënësit bisedojnë në çifte për atë se: Çka nevojitet që të mbjellën farat? Mbjellni dhe kultivoni disa fara që do të rriten shpejt – tregojuni farat dhe lejoni nxënësve të udhëheqin me to.</p> <p>Vendosni lesh pambuku në lëvore të zbrazur të vezës apo në kuti për vezë. Spërkatni disa fara dhe mbani të njoma. Vështroni për çdo ditë. Enët të zbukurohen që të marrin figura dhe të kenë gru i cili do të rritet si flokë. Apo mund të vendosen disa njëri pranë tjetrit të duken si vemje.</p> <p>Vizatoni fotografi apo bëni fotografi gjatë tërë kohës që të tregohet se si mbjellën farat dhe rritja e tyre. Diskutoni se sa ujë duhet shtuar dhe rishikoni se sa kohë do të nevojitet përderisa nuk paraqiten shenjat e para të rritjes.</p>	<p>Fara, mbushje pambuku, ujë, bokall, lëvore të zbrazura të vezëve apo rondele për vezë, materiale artistike për zbukurim.</p> <p>Kamerë digjitale, letër, lapsa dhe fletore pune.</p>	<p>Të sigurohemi se nuk gjenden fara nga nxënësit. Të sqarohet se në disa fara nuk ju duhet tokë apo përzjerje plehrash që të fillojnë të rriten.</p> <p>Vokabular kryesor/nocione: bimë fara rritet mbjell ujit.</p> <p>Hulumtimi shkencor: pyet përgjigjet tregon për/bisedon qëllon/parashikon vizaton/shkruan.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p>Java e 18</p> <p>Hulumton se si farat zhvillohen në bimët që lulëzojnë.</p> <p>E din se bimëve ju duhet dritë dhe ujë që të rriten. Hulumtimi shkencor</p> <p>Shqyrton dëshmi dhe qasje</p> <p>Krahason se çka ka ndodhur me parashikimet.</p>	<p><u>Ora 35: Kultivimi i bimëve më të larta</u></p> <p>Vështroni farat e mbjellura të sallatës jeshile. Identifikoni shenja të rritjes. Diskutoni në çifte: <i>Vallë pse ato janë rritur?</i></p> <p>Këputeni sallatën jeshile kur do të rritet me ndihmën e gërshërëve. Bëni sandviçë me përdorimin e gjetheve të gjelbërta si fill apo shtojcë.</p> <p>Kultivoni disa bimë më të larta – si psh. karota, selino apo ananas. Preni copë prej 1 cm nga maja e bimës, duke i lënë gjethet të paprekura. Vendosni bimën e prerë me majen të qëndrojnë drejtë (karota është e qëlluar për këtë tentim) në gazetë të zbutur/letër kuzhine apo enë, duke e ruajtur letrën e njomë, por mos e shkrini në ujë. Alternativë, futni katër rrëmoja rreth anëve të majeve të prera të bimës, ngjitni rreth gotës, mbushni gotën me ujë deri në pjesën e poshtme të bimës, vendosni në raftin e dritares së diellit dhe siguroni nivelin e ujit që ta prek pjesën e poshtme të bimës.</p> <p>Bisedoni me nxënësit për emrat e pemëve dhe perimeve të cilat ishin të dobishme – vallë paraprakisht kanë hëngër diçka të tillë? Proveni dhe bisedoni për atë se vallë ju pëlqejnë apo jo.</p> <p>Shfrytëzoni mbetjen nga pemët dhe perimet që të bëhen skema të shtypura apo fotografi për ti vendosur në klasë.</p>	<p>Fara të sallatës jeshile nga vetëshërbimi. Thika, bukë, gjalpë, fill për sandviçë, thika plastike.</p> <p>Pemë dhe perime me gjethe në maje, enë dhe gazeta/letër për kuzhinë apo gota/rrëmoja për dhëmbë.</p> <p>Letër, bojë shkrimi apo ngjyra</p> <p>Fotografi (internet apo libra), „Luledielli” të Van Gog, enë për mbjellje, plehëra apo truall, ujë, fara prej luledielli, enë kopshti, linearë apo shiritë për matje, kamera digjitale.</p> <p>Materiale artistike për të bërë fotografi me luledielli apo kolazhe prej farave të ndryshme të thata.</p>	<p>Bleni bimë të rritur sepse nuk ka kohë të rritet fara gjatë kohës së një orë mësimore.</p> <p>Vokabular kryesor/nocione</p> <p>Bimë Gjethe Rritet Mbjell Ujit.</p> <p>Hulumtimi shkencor: Përgjigjet Tregon/bisedon Qëllon/parashikon, shkruan, vizaton.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p><u>Java e 18</u></p> <p>Hulumton se si farat zhvillohen në bimë që lulëzojnë;</p> <p>Din se bimëve ju duhet dritë dhe ujë që të rriten.</p> <p>Hulumtimi shkencor</p> <p>Shqyrton dëshmi dhe qasje Krahason se çka ka ndodhur me parashikimet.</p>	<p><u>Ora e 36: Kultivimi i lulediellit</u></p> <p>Shikoni fotografinë „Luledielli” nga Van Gog. Shikoni disa fara të lulediellit. Lejoni secilit nxënës të mbjell dy fara në saksi të posaçme me tokë apo pleh. Gjatë kohës së dy javëve vijuese organizoni garë: Kush mundet të kultivojë <i>luledielli më të lartë</i>? Mbjellni lulediellin jashtë përderisa nuk bëhen të ndërlidhura me saksinë. Përkrahni kultivimi e bimëve që shfrytëzojnë saksi kopshti apo lejoni nxënësit ti dërgojnë në shtëpi që ti rrisin. Matni apo fotografoni lartësinë e lulediellit të krahasuar me lartësinë e nxënësve. Ngjyrosni fotografitë e Juaja me lulediellin apo bëni kolazh prej farave.</p>		<p>Vokabular kryesor/nocione:</p> <p>Bimë Gjethe Rritet Mbjellët Ujitet</p> <p>Hulumtimi shkencor: Përgjigjet Tregon/bisedon Qëllon/parashikon, shkruan, vizaton.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p>Java e 19 Din se bimëve ju duhet dritë dhe ujë që të rriten.</p> <p>Hulumtimi shkencor Shqyrton dëshmi dhe qasje Propozon ide dhe vijon instruksione. Shqyrton ide dhe qasje Bën krahasime Krahason se çka ka ndodhur me parashikimet.</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese Vendos se çka të bëjë që të përgjigjet pyetjes shkencore; bën parashikime.</p>	<p>Ora e 37: Kultivimi i fasules, pemës apo bimëve (shëruese, për mëlmesa etj) Mateni rritjen (lartësinë e gjetheve në lartësi të bimëve të kultivuara paraprakisht). Bisedoni se nëse janë rritur ajo është sepse kanë ujë të mjaftueshëm dhe dritë. Aktivitetet e mbjelljes që janë bazë e kësaj ore, si edhe vëzhgimi i rritjes do të zgjat prej pesë ditë.</p> <p>Të tregon disa pjesë të fasules dhe të sqarohet se ata janë diçka vijuese që nxënësit do ti rrisin. Të tregohet ajo që duhet të bëhet – të vihen në enë pjesët e fasules në kavanoz prej qelqi dhe pak ujë dhe bukur të lahen. Lejeni të bymehen gjatë natës. Lani dhe thani kokërrzuat gjatë ditës. Sqaroni se si mundet ti incizojnë ndryshimet gjatë disa ditëve. Deri në ditën e tretë rritja mund të vërehet ndërsa deri në ditën e pestë rritja duhet të përfundojnë. Largoni nga kavanozi prej qelqi dhe vendosni në frigorifer të të pengohet rritja e më tutjeshme. Jashtë kohës së paraparë për orë, përgatitni sallatë duke përdorur edhe fasule – hani dhe kënaquni.</p> <p>Shikoni pemën e vërtetë dhe lojërat – pemë (si psh. të bëra prej druri, plastike). Bëni prerje dhe vëzhgoni skemat që farat i bëjnë brenda në pemë. Diskutoni faktin se pemët e reja (të llojit të njëjtë) rriten prej farave.</p> <p>Siguroni që të rritet pema prej farës më të madhe (kumbulla, pjeshka, qershia, nektarin). Fara të lirohet nga pjesa e fortë dhe të mbështillet me vatë të lagur apo letër absorbuese dhe kështu të lihet në qese e cila mund</p>	<p>Fasulja, kavanozat prej qelqi, uji, kavanozat, reçetat për sallatë, (dhe mëlmesa), mjete për gatim.</p> <p>Përmbledhje të pemëve të ndryshme dhe të vërteta dhe artificiale, thika prej plastike.</p> <p>http://www.youtube.com/watch?v=XS8jQoWSqaU</p> <p>Fara, prej peme (pjeshkë, kumbull, nektarin etj),. Kruese për veshë, vatë pambuku apo letër absorbuese, letër me mundësi që të mbyllen, kavanoz prej qelqi, ujë, bokall.</p> <p>Dy bimë të ndryshme/identike, ujë, bokall.</p> <p>Letër dhe lapsa apo fletore pune, kamerë digjitale.</p> <p>Barnishtat natyrale dhe artificiale, fara, enë për bimët, tokë apo pleh, ujë, bokall.</p> <p>Libra me receta dhe mëlmesa</p>	<p>Vokabular kryesor/nocione</p> <p>Bimë Gjethë Rritet Mbjell Ujit.</p> <p>Hulumtimi shkencor: Përgjigjet Tregon/bisedon Qëllon/parashikon, shkruan, vizaton.</p>

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
	<p>të mbyllet bukur. Procesi mund të shikohet në linkun që ofrohet.</p> <p>Kultivoni bimë – të shikohen dhe të krahasohen versionet e thata dhe bimët – barërat. Bisedoni se ku i shfrytëzojmë bimët specifike për shembull: në picë, në supë etj. Nëse janë përdorur bimët e vërteta/barishte, shikoni strukturën e tyre dhe krahasoni gjethet, rrënjët dhe kërcelli (nëse janë të dukshme) dhe gjethet (nëse ekzistojnë). Mbjellni disa fara të bimëve duke i përcjellë instruksionet e paketëve nga farat. Vëzhgoni rritjen tërë kohën.</p> <p>Bëni receta kur përdoren barishta që rriten (të freskëta) apo mostra të thata (të blera).</p> <p>Vizatoni pasqyrë në tabelë në të cilën prezantohen fazat e mbjelljes së farave.</p>	<p>për reçeta të zgjedhura.</p> <p>Letër dhe lapsa apo fletore pune.</p>	
<p>Java e 19</p> <p>Din se bimëve ju duhet dritë dhe ujë që të rriten.</p> <p>Hulumtimi shkencor Shqyrton dëshmi dhe qasje Propozon ide dhe vijon instruksione. Shqyrton ide dhe qasje Bën krahasime Krahason se çka ka ndodhur me parashikimet.</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese Vendos se çka të bëjë që të përgjigjet pyetjes shkencore;</p>	<p><u>Ora e 38: Sa ujë u nevojiten bimëve?</u></p> <p>Shikoni dhe krahasoni dy bimë të shëndosha. Bisedoni në klasën që do të ndodhë nëse të njëjtat nuk ujitin disa ditë. Si do ta kuptojmë dhe çka do të ndodhë nëse nuk ujitin bimët? Vendosni eksperiment ku bima e parë është e ujitur normalisht ndërsa tjetra nuk është. Të ujitet bima e dehidruar kur toka është e thatë. Për testim korrekt (të siguruara kushtet e njëjta) të përdoret e njëjta sasi e ujit çdoherë kur matet bima. Të njëjtat të ruhen në lokacione të njëjta. Të jeni të sigurt se të dy bimët nuk janë të lidhura reciprokisht me rrënjët – rrënjëve u nevojitet vend për rritje.</p> <p>Caktoni dallimet me vizatim apo me bërjen e fotografive për ekspozitë. Ky aktivitet duhet të realizohet jashtë orës së rregullt, nëse lejon koha.</p>	<p>Dy identitete të ndryshme/bimë të ndryshme, ujë, bokall</p> <p>Letër dhe stilolaps, fletore, kamerë digjitale</p>	

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)			
<p>bën parashikime.</p> <p><u>Java e 20</u></p> <p>Din se bimëve ju duhet dritë dhe ujë që të rriten.</p> <p>Hulumtimi shkencor Shqyrton dëshmi dhe qasje Propozon ide dhe vijon instruksione. Shqyrton ide dhe qasje Bën krahasime Krahason se çka ka ndodhur me parashikimet.</p> <p>Planifikimi i punës hulumtuese Vendos se çka të bëjë që të përgjigjet pyetjes shkencore; bën parashikime.</p>	<p><u>Ora e 39:</u></p> <p>Me vënien e bimës që të rriten në dy vende të ndryshme para orës ju mundësohet nxënësve të bëjnë krahasime të suksesshme gjatë orës.</p> <p>Testoni rritjen e bimës në dritë, me pak apo pa dritë. Krahasoni dy bimë identike të cilat kanë qenë të trajtuar njëjtë – sasia e tokës apo pleh, sasia e ujit në ditë. Bëni dallim në lokacionin e bimës – në errësirë apo në dritë. Krahasoni të dy bimët gjatë kohës në disa ditë dhe shënoni atë që e shikoni.</p> <p>Vëzhgoni disa bimë mishngrënëse – si shembull. Venus flutrap apo Cape Sundew. Tregoni bimën e vërtetë dhe se si ajo funksionon – pjesa ngjitëse e Cape Sundew e robëron insektin, mandej gjethi lakohet rreth tij dhe e han. Tregoni se si funksionon ajo me përdorimin e fishkëllyeseve të lakuar siç janë në aheng me pjesën ngjitëse në fund. Ngjitni pjesën e prerë me fotografinë e insektit. Kur fryhet në fishkëllyesen ngjitëse të lakuar insekti mund të shihet mandej të jetë i rrotulluar për brenda, ngjashëm me atë se si funksionon bima.</p> <p>Venus flutrap – mizat e robëruara mund të shihen me mbajtjen e bimës të drejtuar në dritë. Luani lojën në role ku do të jeni si Sape Sundew apo Venus flutrap.</p> <p><u>Ora e 40:</u> Vazhdoni me vëzhgimin e bimëve të larta.</p> <p>Në mënyrë të vazhdueshme i ndërprisni mbirjet e fasules.</p>	<p>Dy bimë identike, pleh apo tokë, enë për bimë, ujë, bokall, dritë dhe vend i errët, letër dhe lapsa apo fletore pune.</p> <p>www.youtube.com të kërkohet bima sipas emrit.</p> <p>Fishkëlluese si në aheng, shirit ngjitës dyanësh, ilustrime të vogla prej insekteve, gërshërë.</p>	

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Biologji (Bimët)	<p>Në çifte bisedoni: <i>Sa lloje të ndryshme të fasuleve njohim?</i></p> <p>Prezantoni një grumbull fasulesh për mbjellje. Tregoni se si kultivohen fasulet në kavanoz prej qelqi me letrën e njomë. Vendose fasulen në kavanozin prej qelqi në të cilën ka role të njomë apo letër absorbuese. Mbusheni kavanozin me ujë me thellësi prej 1 cm dhe tërë kohën mbani atë nivel.</p> <p>Në çifte apo në grupe të vogla vendosni apo vëzhgoni llojet e ndryshme të kokërrzove (fasule, gru etj) të cilat rriten. Diskutoni: <i>Çka u nevojitet farave që të rriten?</i></p> <p>Vizatoni një paraqitje në tabelë – seri fotografish që të përshkruhet rritja e farave.</p> <p>Menjëherë pasi farat fillojnë të rriten të njëjtat duhet të barten në enë më të vogla me pleh apo tokë apo t’ju lejohet nxënësve ti sjellin në shtëpi. Disa lloje të farave do të rriten lartë – këto mund të jenë të mbjellura në enë me bimë. Këputni dhe hani frutat pas lulëzimit. ?</p> <p>Bëni disa kolazhe prej farave me përdorimin e kokrrave të freskëta apo të thata.</p>	<p>Llojlojshmëri e kokrrave të ndryshme, kavanoza prej qelqi, letër absorbuese, ujë, bokall.</p> <p>Letër dhe lapsa apo fletore pune.</p> <p>Enë për bimët, tokë apo pleh, enë kopshti.</p> <p>Letër, ngjitës, fasule e thatë apo fara tjera.</p>	